

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Tetor 2017

Tiranë, më 21 Nëntor 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Tetor 2017 është 795.855. Krahasuar me Tetor 2016, ky tregues rezulton me rritje 16,4 %.


Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 379.327. Krahasuar me Tetor 2016, ky numër është rritur me 25,3 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në dhjetëmujorin e 2017 është 4.604.010, duke u rritur me 7,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Në Tetor 2017, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 4 herë, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Anglia me 49,8 %.

Në dhjetëmujorin e 2017, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 73,9 % dhe rënie kanë patur vetëm hyrjet nga Kosova me 21,1 %. (shih tab 2.)

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Tetor 2017, janë 815.646, duke shënuar një rritje me 11,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Tetor 2017, është 430.505. Krahasuar me Tetor 2016, ky numër është rritur 7,6 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në dhjetëmujorin e 2017 është 4.368.360, duke u rritur 5,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Hyrjet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë në muajin Tetor 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 81,0 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 14,3 % dhe detare zënë 4,7 %.

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Tetor-16	Tetor-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Tetor 16	Janar-Tetor 17	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Gjithsej	683.663	795.885	16,4	8.099.844	8.598.922	6,2
Shqiptarë	380.829	416.558	9,4	3.800.400	3.994.912	5,2
Të Huaj	302.834	379.327	25,3	4.299.444	4.604.010	7,1
Dalje Gjithsej	732.728	815.646	11,3	8.430.706	9.040.896	7,2
Shqiptarë	400.012	430.505	7,6	4.128.781	4.368.360	5,8
Të Huaj	332.716	385.141	15,8	4.301.925	4.672.536	8,6

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Tetor-16	Tetor-17	Ndryshim vjetor %	Janar-Tetor 16	Janar-Tetor 17	Ndryshim vjetor progresiv %
Kosovë	95.072	94.723	-0,4	2.025.206	1.598.317	-21,1
Maqedoni	42.745	58.739	37,4	498.932	568.740	14,0
Greqi	38.451	75.759	97,0	344.320	427.223	24,1
Itali	22.719	21.839	-3,9	222.913	316.286	41,9
Angli	10.225	5.130	-49,8	91.979	116.548	26,7
Mali i zi	26.384	33.633	27,5	275.967	323.892	17,4
Poloni	2.305	9.213	299,7	65.184	113.356	73,9
SHBA	7.206	5.282	-26,7	75.112	89.744	19,5
Gjermani	8.708	10.247	17,7	76.338	112.054	46,8
Zvicër	2.516	1.649	-34,5	33.790	50.681	50,0
Të tjera	46.503	63.113	35,7	589.703	887.169	50,4
Gjithsej	302.834	379.327	25,3	4.299.444	4.604.010	7,1

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Tetor-16	Tetor-17	Janar-Tetor 16	Janar-Tetor 17
Hyrje Shtetas të Huaj	302.834	379.327	4.299.444	4.604.010
I. Personale	298.838	374.506	4.252.161	4.547.282
1. Pushime	88.202	168.465	1.855.512	2.263.395
2. Vizitë në miq e të afërm	1.118	931	16.589	16.582
3. Vizitë ditore	17.887	25.610	491.016	265.440
4. Trajtim shëndetësor	73	82	572	460
5. Qëllime fetare	56	15	807	502
6. Vizitorë të tjerë	179.735	168.760	1.751.395	1.847.691
7. Udhëtarë tranzit	11.767	10.643	136.270	153.212
II. Biznes dhe profesionale	3.996	4.821	47.283	56.728

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Tetor - 16	95.825	43.558	544.280	102.972	44.068	585.688
Tetor - 17	113.449	37.588	644.848	119.514	38.724	657.408
Ndryshimi vjetor (%)	18,4	-13,7	18,5	16,1	-12,1	12,2
Janar-Tetor 2016	905.061	568.433	6.626.350	901.777	640.430	6.888.499
Janar-Tetor 2017	1.103.198	676.946	6.818.778	1.131.930	728.120	7.180.846
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	21,9	19,1	2,9	25,5	13,7	4,2

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>